



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 26091 prot.

Shkodër, më 22.12. 2025

VENDIM

Nr. 82, datë 18.12.2025

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2027–2029 DHE BUXHETIT VJETOR 2027**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 33 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësive të qeverisjes vendore”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, “Mbi procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, si dhe dokumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Miratimin e Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 dhe buxhetit vjetor 2027, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 40 vota

Vota Pro	40
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	19.12.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj



Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

Kalendari PBA & buxhetit vjetor

- Përgatitet nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe i propozohet më tej Këshillit të njësisë;
- Miratohet nga këshilli i njësisë;
- Hyn në fuqi dhe shpërndahet te të gjitha njësitë shpenzuese nga kryetari i njësisë (Janar .2026).

Vlerësimet dhe parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve

- Kryetari paraqet për shqyrtim dhe miratim në këshill (brenda 31.01. viti 2026);
- Këshilli miraton raportin e vlerësimeve (1.03. viti 2026).

Tavanet e shpenzimeve të PBA në nivel programi

- Kryetari i njësisë propozon tavanet përgatitore për miratim në këshill (1.03. viti 2026);
- Këshilli miraton tavanet përgatitore (15.03. viti 2026);
- Kryetari i njësisë miraton udhëzimin për përgatitjen e buxhetit (5 ditë nga miratimi i tavanëve);
- Udhëzimi shpërndahet te njësitë shpenzuese (5 ditë nga miratimi i tavanëve / 20.03. viti 2026);
- Tavanet përfundimtare paraqiten nga kryetari i njësisë në këshill (korrik viti 2026);
- Këshilli miraton tavanet përfundimtare (20.07.viti 2026);
- Kryetari i njësisë nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të njësisë dhe e shpërndan te të gjitha njësitë shpenzuese (5 ditë nga miratimi i tavanëve përfundimtare / 25.07. viti 2026).

Kërkesat sipas tavanëve

- Njësitë shpenzuese paraqesin kërkesat brenda tavanëve përgatitore te Njësia e Menaxhimit të Programeve (prill.viti t) dhe japin argumente për fonde / tavane shtesë;
- Njësitë shpenzuese paraqesin kërkesat brenda tavanëve përfundimtare (1.08. viti 2026).

PBA & Buxheti vjetor

- Kryetari i njësisë përgatit dokumentin I të PBA viti t+1, t+2, t+3 (30.05.2026)
- Kryetari i njësisë dërgon MFE PBA (1.06. viti 2026); •MFE-ja dërgon opinionin e saj mbi PBA-në te njësia vendore (20.06. viti 2026);
- Kryetari i njësisë vendore dërgon PBA-në së bashku me opinionin e MFE-së për miratim në Këshill (21.06. viti 2026);
- Këshilli i njësisë vendore miraton dokumentin e parë të PBA-së (30.06. viti 2026);
- Kryetari publikon PBA / dokumentin I (5.07 viti 2026);
- MFE-ja nxjerr udhëzimin plotësues për rishikimin e PBA-së (10. korrik viti 2026);
- Njësia rishikon PBA-së (korrik - gusht viti 2026);
- Njësia organizon takime konsultuese (1-15.09. viti 2026);
- Njësia dërgon PBA-në e rishikuar te MFE-ja 15.09.2026
- MFE-ja zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore (5.10.2026);
- MFE-ja dërgon opinionin përfundimtar sipas rastit te njësia vendore (20.10.2026);
- Kryetari i bashkisë paraqet për miratim në Këshill PBA-në dhe buxhetin vjetor përfundimtar (30.11.2026);
- Këshilli miraton PBA-në dhe buxhetin vjetor (25.12.2026);
- Kryetari i njësisë publikon PBA-në dhe buxhetin vjetor dhe materialet shoqëruese (31.12.2026).